



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:192927

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06517173

C.nr.2680/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku në çështjen juridike-kontestimore të paditësve D..... (E....) B....., L..... (E....) B....., F..... B..... dhe A..... (E....) B.....nga fsh. Gll..... Komuna e P....., të cilët i përfaqëson Njomza Hoxha avokate nga Peja, kundër të paditurve M...(Z..) K....., N...(Z..) K.....dhe P...(Z..) K.....që të gjithë nga fsh Gll..... Komuna e P....., të cilët i përfaqëson me autorizim S..... M.....avokat nga Peja, baza juridike: vërtetim pronësie, vlera e kontestit 5,000 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 25.11.2024 moir kurse me datë 27.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

-në bazë të pohimit-

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve D..... (E....) B..... dhe L..... (E....) B....., F..... B..... dhe A..... (E....) B.....nga fsh.Gll..... Komuna e P....., NË TËRËSI E BAZUAR.
- II. VËRTETOHET se paditësve D..... (E....) B....., L..... (E....) B....., F..... B..... dhe A..... (E....) B.....nga fsh. Gll..... Komuna e P....., u takon e drejta e pronësisë mbi bazën e mbajtjes me nga ¼ të pjesëve ideale të ngastrës kadastrale nr. 1.-2. ZK Gll..... me sipërfaqe prej 3870 m2 dhe DETYROHEN të paditurit M...(Z..) K....., N...(Z..) K.....dhe P...(Z..) K.....që të gjithë nga fsh. Gll..... Komuna e P.... që paditësve të u'a pranojnë të drejtën e pronësisë si në pikën II të këtij aktgjykimi dhe të lejojë që paditësit të regjistrohen si bashkëpronar të ngastrës në fjalë në Zyrën Kadastrale në Komunën e P....., në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit D..... (E.....) B..... dhe L..... (E.....) B....., F..... B..... dhe A..... (E.....) B.....nga fsh.Gll..... Komuna e P....., të cilët i përfaqëson Njomza Hoxha avokate nga Peja sipas autotorizimit, kundër të paditurve M....Z..) K....., N...(Z..) K.....dhe P...(Z..) K.....që të gjithë nga fsh Gll..... Komuna e P....., të cilët i përfaqëson me autorizim S..... M.....avokat nga Peja, kanë ngritur padi nga baza juridike: vërtetim pronësie, vlera e kontestit 5,000 euro.

Në padi është theksuar se paditësit janë pasardhësit e E.B, i cili në vitin 1995 nga të paditurit ka blerë njësinë kontestuese. Palët kontraktuese, në atë kohë kishin lidhur kontratë interne e cila është djegur gjatë luftës, kurse paraardhësi i paditësve ka përmbushur në tërësi çmimin kontraktual prej 18,000 DM, kurse janë në posedim që nga ajo kohë, të pa trazuar apo shqetësuar nga askush.

Të paditurit, përmes të autorizuarit të tyre, e kanë pohuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe i kanë pohuar në tërësi faktet e cekura në padi.

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes e edhe përkundër pohimit të kërkesëpadisë nga i padituri, ka shtyrë marrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, me qëllim të verifikimit dhe marrjes së njoftimeve të duhura në kuptim të nenit 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka caktuar seancën e vend shikimit dhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së gjeodezisë. Nga provat që i janë bashkangjitur kësaj ekspertize konkretisht nga certifikata e pronës e dt.03.09.20.., vërtetohet se të paditurit janë pronar me nga 1/3 të ngastrës kadastrale 1..-2. ZK Gll..... në sip.3870 m2.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, thënieve në padi dhe pohimit nga të paditurit, ka gjetur se janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me pohimin e palës së paditur, nga të cilat vërtetohen faktet relevante se palët mund të disponojnë me kërkesat e tyre, ashtu që të paditurit janë pronar i njësisë kontestuese dhe mund të disponojë me kërkesën e tyre. Ky pohim i kërkesëpadisë po ashtu nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 3.2 i LPK e lidhur me dispozitat materiale nga neni 28 i LMTHPJ-së, pasi që kërkesëpadia ka bazë materiale mbi të cilën paditësve u derivon e drejta e pronësisë, sepse fillimisht padia duhet të

ketë bazën materiale nga derivon e drejta e pronësisë, në mënyrë që edhe pohimi i kërkesëpadsisë të mos jetë në kundërshtim me dispozitat materiale.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadsisë nga ana e të paditurit, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj në kuptim të nenit 148 paragrafi 1 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se “ *në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadsinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesën (aktgjykimi në bazë të pohimit)*”- vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori bazuar në nenin 450 të LPK- së, pasi që palët nuk i kanë kërkuar shpenzimet.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 dhe 148.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:192927, C.nr.2680/23, Dt.27.11.2024

G j y q t a r i:
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.